REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

# VENDIM

Nr. 70, datë 21.07.2025

PËR

"MIRATIMIN MARRËVESHJES TË BASHKËPUNIMIT PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT TË INVESTIMIT "PËR ZHVILLIMIN DHE MENAXHIMIN E PRONËS SHTETËRORE, NËNPROJEKTIT "RIJETËZIMI I STADIUMIT SKËNDERBEU KORÇË DHE ZONËS URBANE RRETH TIJ" DHE VENDOSJEN NË DISPOZICION TË PROJEKTIT, TË PRONAVE NË PRONËSI BASHKISË KORÇË.

Këshilli Bashkiak i mbledhur sot ,pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga ekzekutivi si dhe bazuar në Ligjin 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" të ndryshuar; Ligji 107/2014 "*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*"; ligji 79/2017 "*Për sportin*"; VKM nr.17 date 18.01.2023 "*Për ngarkimin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, si organ qendror blerës, për realizimin e konkursit të projektimit për projektidetë e rikonceptimit të kompleksëve sportive të stadiumeve në qytetet e Durrësit, Korçës dhe Vlorës*"; VKM 1532 date 19.11.2008 "*Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Bashkisë Korçë të Qarkut të Korçës*", Ligjin 71/2019 "Për korporatën e Investimeve Shqiptare" , VKM 137/2014 "Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurës për dhënien e pronës shtetërore me qira, enfiteozë, leasing, shitje, përdorim si kolateral dhe të përdorimit në forma të tjera nga ana e Korporatës të Investimeve Shqiptare"

VENDOSI

1. Të miratojë draft marrëveshjen e bashkëpunimit për zbatimin e projektit të investimit "*Për zhvillimin dhe menaxhimin e pronës shtetërore" dhe nënprojektit "Rijetëzimi i Stadiumit Skënderbeu Korçë dhe zonës urbane rreth tij" sipas teksit bashkalidhur dhe anekset 1 2 dhe 3.*

2. Të japë autorizimin në favor të AIC/ SPV të aplikojë pranë institucioneve publike për marrje dokumentacioni, informacioni të nevojshëm, për pronën apo çdo informacion tjetër të nevojshëm, që lidhet me realizimin e projektit të investimit
3. Të autorizojë AIC/SPV për të zhvilluar garën e përzgjedhjes të partnerit privat i cili me fondet e tij do të realizojë projektin e investimit në këmbim të pjesës së tij takuese të ofruar në konkurs si dhe në këmbimin në natyrë të pjesës takuese të palës publike Bashkia Korçë në pronën e zhvilluar kundrejt pronës të zhvilluar për interes publik, sipas vlerës së pronës të përcaktuar në pasaportën e eficiecës të pronës përkatëse, të llogaritur sipas VKM 137/2024 e ndryshuar apo edhe të të drejtave të menaxhimit të pjesës takuese të BK, nëse është e nevojshme, sipas përcaktimeve në këtë marrveshje dhe në marrëveshjen e pjesëve takuese;
4. Vendos në dispozicion në AIC/SPV, pronën për zhvillim publik nëpërmjet procesverbalit me shkrim ("Proçesverbali i dorëzimit të pronës"), brenda 30 ditëve pune, nga data e zbardhjes të vendimit të dhënies të lejës së ndërtimit nga enti publik përgjegjës për miratimin e lejës. Bashkia Korçë mer përsipër detyrimin/ apo bie dakort që të mos kryejë asnjë veprim që lidhet me vënien në dispozicion të pronës apo të të drejtave që lidhen me të, subjekteve të treta publike apo private, deri në momentin e dorëzimit të pronës shtetërore AIC.
5. Pronat të cilat do të vendosen në dispozicion të AIC janë pasuritë:
   - Pasuria Nr.1/5, ZK.8561, me sipërfaqe 23934.7 m2 e llojit Terren Sportiv, nga të cilat 323.3 m2 janë të llojit Ndërtesë, në pronësi të Bashkisë Korçë.
   - Pasuria Nr.1/4, ZK.8561, me sipërfaqe 464.1 $m^2$ e llojit Trotuare, në pronësi të Bashkisë Korçë.
   - Pasuria Nr.1/3, ZK.8561, me sipërfaqe 337.5 $m^2$ e llojit Trotuare, në pronësi të Bashkisë Korçë.
   - Pasuria Nr.1/560, ZK.8561, me sipërfaqe 137.3 $m^2$ e llojit Trotuare, në pronësi të Bashkisë Korçë.
   - Pasuria Nr.1/580, ZK.8561, me sipërfaqe 20.1 $m^2$ e llojit Truall, në pronësi të Bashkisë Korçë.
   - Pasuria Nr.1/561, ZK.8561, me sipërfaqe 102 $m^2$ e llojit Trotuare, në pronësi të Bashkisë Korçë.
   - Pasuria Nr.1/562, ZK.8561, me sipërfaqe 192.2 $m^2$ e llojit Trotuare, në pronësi të Bashkisë Korçë.
   - Pasuria Nr.1/6, ZK.8561, me sipërfaqe 528.9 $m^2$ e llojit Trotuare, në pronësi të Bashkisë Korçë.
   - Pasuria Nr.1/563, ZK.8561, me sipërfaqe 461.1 $m^2$ e llojit Trotuare, në pronësi të Bashkisë Korçë.
   - Pasuria Nr.1/25, ZK.8561, me sipërfaqe 8553.5 $m^2$ e llojit Rrugë, në pronësi të Bashkisë Korçë.

- Pasuria Nr.1/581, ZK.8561, me sipërfaqe 1033.4 $m^2$ e llojit Truall, nga të cilat 180.8 $m^2$ janë të llojit Ndërtesë, në pronësi të Bashkisë Korçë.
- Pasuria Nr.1/11, ZK.8561, me sipërfaqe 4746.8 $m^2$ e llojit Rrugë, në pronësi të Bashkisë Korçë.
- Pasuria Nr.1/19, ZK.8561, me sipërfaqe 1208.4 $m^2$ e llojit Truall, në pronësi të Bashkisë Korçë.
- Pasuria Nr.1/559, ZK.8561, me sipërfaqe 356.6 $m^2$ e llojit Trotuare, në pronësi të Bashkisë Korçë.
- Pasuria Nr.1/547, ZK.8561, me sipërfaqe 24.4 $m^2$ e llojit Shesh, në pronësi të Bashkisë Korçë.
- Pasuria Nr.1/912, ZK.8561, me sipërfaqe 85836 $m^2$ e llojit Truall, nga të cilat 250 $m^2$ janë të llojit Ndërtesë, në pronësi të Bashkisë Korçë.
- Pasuria Nr.1/17, ZK.8561, me sipërfaqe 1564.6 $m^2$ e llojit Trotuare, në pronësi Shtet.
- Pasuria Nr.1/7, ZK.8561, me sipërfaqe 1012.8 $m^2$ e llojit Trotuare, në pronësi të Bashkisë Korçë.
- Pasuria Nr.1/539, ZK.8561, me sipërfaqe 47.3 $m^2$ e llojit Shesh, në pronësi të Bashkisë Korçë.
- Pasuria Nr.1/540, ZK.8561, me sipërfaqe 48.6 $m^2$ e llojit Shesh, në pronësi të Bashkisë Korçë.
- Pasuria Nr.1/541, ZK.8561, me sipërfaqe 46.7 $m^2$ e llojit Shesh, në pronësi të Bashkisë Korçë.
- Pasuria Nr.1/542, ZK.8561, me sipërfaqe 49 $m^2$ e llojit Shesh, në pronësi të Bashkisë Korçë.
- Pasuria Nr.1/543, ZK.8561, me sipërfaqe 50.2 $m^2$ e llojit Shesh, në pronësi të Bashkisë Korçë.

6. Të autorizojë Kryetarin e Bashkisë Korçë të nënshkruajë marrëveshjen 4 palshe midis Ministrisë së Arsimit; Bashkisë Korçë, Federata Shqiptare e Futbollit dhe Korporata e Investimeve Shqiptare.

7. Të ndryshojë VKB nr 118 dt 31.08.2023 "Për miratimin dhe vënien në dispozicion të projektit sipas VKM 17 dt 18.01.2023 "Për ngarkimin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit si Organ qëndror Blerës, për realizimin e konkursit të projektimit për projektideté e rikonceptimit të kompleksеve sportive të stadiumeve në qytetet e Durrësit, Korçës dhe Vlorës".

8. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe e Menaxhimit të Burimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit Kontrollit dhe Menaxhimit të Kontratave të Infrastrukturës.

9. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore").

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Eva NAÇI

KRYETARE
ANA VERUSHI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA KORÇË

Miratuar me 23 vota
Vota Pro 23
Vota Kundër 4
Vota Abstenim 0
Zbardhur më datë 21-07-2025